

Numri: **KSC-BC-2020-06**
**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit,
Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendos: **Gjykatësi i Procedurës Paraprake**
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrës Parashtrues: Mbrojtësi i z. Rexhep Selimit

Data: 12 dhjetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i redaktuar publik i
Kërkesës së Mbrojtjes për lirim të përkohshëm, dosja
KSC-BC-2020-06/F00124 me datë 7 dhjetor 2020

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Dejvid Huper

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkateswari Alagendra

I. HYRJE

1. Mbrojtja e z. Rexhep Selimi kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake të miratojë lirimin e përkohshëm të tij në përputhje me nenin 41(6) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores.
2. Z. Selimi është njeri i përkushtuar familjar, i martuar dhe me dy fëmijë të vegjël që jetojnë në shtëpinë e familjes së ngushtë dhe të qëndrueshme ku ai dëshiron të kthehet dhe të qëndrojë gjatë tërë fazës së procedurës paraprake, deri sa të kthehet në Hagë për të kundërshtuar fuqishëm akuzat kundër tij gjatë gjyqimit. Si anëtar i Kuvendit të Kosovës, z. Selimi prej kohësh ka lidhje profesionale vetëm me Kosovën. Ai nuk ka asnjë motiv, interes ose synim të arratiset nga shtëpia e tij në Prishtinë.
3. Gjatë gjithë këtij procesi gjyqësor dhe procedura të tjera të lidhura me të, ai ka përmbytur të gjitha obligimet që i janë kërkuar nga Dhomat e Specializuara (“DHSK”) dhe Prokurori i Specializuar (“ZPS”), [REDAKTUAR], dhe nuk ka asnjë indikacion konkret se nuk do të vazhdojë ta bëjë të njëjtën gjë. Shqetësimet që paraqet Prokuroria sa i përket lirimit të z. Selimi janë qartësisht të rrejshme dhe/ose të gabuara, duke pasur parasysh angazhimin e tij të vazhdueshëm me DHSK-në, [REDAKTUAR] dhe prokurorët e ndryshëm që kanë i kërkuar të japë deklaratë dëshmitari [REDAKTUAR]. ZPS-ja duket se nuk e ka informuar Gjykatësin e Procedurës Paraprake për angazhimin e konsiderueshëm të z. Selimi në këtë proces [REDAKTUAR]. Në vend të kësaj, ZPS-ja, e cila në dukje e mirëpriti bashkëpunimin e tij, domethënë faktin që ai iu përgjigj pyetjeve të tyre në intervistë, tani kanë vendosur të hedhin dyshime mbi karakterin e tij dhe t'ia njollosin emrin.
4. Nëse bëhet vlerësimi i sjelljes, rrethanave dhe bashkëpunimit të gjerë të mëparshëm të tij si individ me DHSK-në dhe ZPS-në, është e qartë se kushtet e nenit 41(6)(b) nuk përmbyshen dhe se z. Selimi duhet të lirohet pa kushte. Si alternativë, miratimi i lirimit të përkohshëm me kushte të arsyeshme të vendosura nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, do të përbënte masë efektive dhe më pak kufizuese për të siguruar pjesëmarrjen e z. Selimi në gjykim dhe mbrojtjen e integritetit të hetimeve të ZPS-së.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Neni 41(6) i Ligjit Nr. 05/L-053 parasheh që Dhomat e Specializuara urdhërojnë arrestimin dhe paraburgimin e një personi kur: ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer një veprë penale që është nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara; dhe ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se: (i) ekziston rreziku që personi të arratiset, (ii) ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë prova, ose ekzistojnë rrethana të caktuara sugjerojnë se personi do të pengojë ecurinë e procedurës penale; ose (iii) do të përsërisë ose do të tentojë të përsërisë veprën (veprat) penale. Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2012, Ligji Nr. 04/L-123, standardi provues i “dyshimit të bazuar” përkufizohet si “njohuri për informacionin që do të bindë një vrojtues objektiv se një veprë penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme se do të ndodhë dhe se ka më shumë gjasa që personi në fjalë ta ketë kryer veprën penale se sa të mos e ketë kryer atë”.
6. Neni 41(10) i Ligjit të DHSK-së, nr. 05/L-053, parasheh që deri në kohën kur aktgjykimi të marrë formë të prerë ose deri në lirim nga paraburgimi, me kalimin e dy (2) muajve pas aktvendimit të fundit për paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose paneli i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për paraburgim dhe nxjerrin aktvendim për lirim apo përfundimin e paraburgimit.
7. Neni 41(12) i Ligjit parasheh që, përveç paraburgimit, Dhomat e Specializuara mund të urdhërojnë edhe masat në vijim për të siguruar praninë e të akuzuarit në proces, për të parandaluar përsëritjen e kryerjes së veprës penale, apo për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të procesit penal: fletëthirrjen, urdhërarrestin, dorëzanimin me kusht, paraburgimin shtëpiak, premtimin që të mos largohet nga vendbanimi, ndalimin që t'i afrohet vendeve apo personave të caktuar, paraqitjen në stacionin e policisë apo në një vend tjetër, dhe masa shmangëse të paraburgimit.
8. Rregulla 56(2) parasheh që Paneli siguron që një person të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes. Rregulla 56(3) e Rregullores parasheh që Paneli mund të urdhërojë lirimin e përkohshëm të të paraburgosurit, kur ky lirim përlligjet prej arsyeve humanitare bindëse.

III. PARASHTRIME

A. Supozimi në favor të lirimimit të përkohshëm dhe kohëzgjatja e procedurës paraprake

9. Neni 41(6) i Ligjit pranon parimin se mbajtja në paraburgim e një të akuzuari para Dhomave të Specializuara në pritje të gjykimit është rasti përjashtimor dhe mund të miratohet vetëm nëse ZPS-ja e bind Gjykatësin e Procedurës Paraprake se janë përmbushur kriteret e nenit 41(6)(a) dhe një kriter i nenit 41(6)(b)(i)-(iii). Në mungesë të provave për këtë, paraburgimi nuk mund të urdhërohet.
10. Rrjedhimisht, barra për të provuar përmbushjen e këtyre kushteve i takon gjithmonë ZPS-së, pavarësisht miratimit të mëparshëm të kërkesës së saj për fletarrestim nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.¹ Ndonëse natyra *ex parte* e asaj kërkesë të ZPS-së mund të ketë qenë e nevojshme në fazën në të cilën ajo u paraqit, kur Aktakuza kundër z. Selimi ishte konfidenciale, kjo nuk do të thotë assesi se z. Selimi duhet ta bindë Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të rishqyrtojë vendimin e tij të mëparshëm. Rrjedhimisht, dhe pas parashtrimeve të paraqitura gjatë konferencës për ecurinë e çështjes, ZPS-ja ka detyrimin që t'i arsyetojë këto kushte, ndërsa Mbrojtja vetëm që t'u përgjigjet atyre argumenteve. Sidoqoftë, në interes të shpejtimit të procesit dhe minimizimit të pasojave për lirinë e z. Selimi, Mbrojtja paraqet argumente materiale në lidhje me kushtet për urdhërimin e paraburgimit. Mund të bëhen edhe parashtrime të tjera me shkrim në kundërpërgjigje të përgjigjes së ZPS-së.
11. Në këtë aspekt, është e qartë se kohëzgjatja e procedurës paraprake do të ketë ndikim mbi lirimimin e përkohshëm. Siç u diskutua gjerësisht në konferencën për ecurinë e çështjes dhe sikurse u ritheksua në parashtrimet e mëtejshme të ZPS-së,² vlerësimet e palëve se kur do të fillojë gjykimi i kësaj çështjeje janë mjaft të ndryshme.
12. Sugjerimi i ZPS-së se gjykimi mund të fillojë në verën e vitit 2021, nuk merr parasysh realitetin e procedurave penale ndërkombëtare. Pavarësisht se zyrtarisht DHSK-ja është gjykatë brenda sistemit gjyqësor të Kosovës, format e zgjeruara të përgjegjësisë penale,

¹ Prokurori k. Thaçit dhe të tjerëve, Vendim për kërkesën për fletarrestime dhe urdhra transferimi, KSC-BC-2020-06/F00027, 26 tetor 2020, para. 26 ("Vendimi për fletarrestime").

² Prokurori k. Thaçit dhe të tjerëve, Parashtrime të prokurorisë pas konferencës së 18 nëntorit 2020 mbi ecurinë e çështjes, KSC-BC-2020-06/F00097, 23 nëntor 2020 ("Parashtrimet e mëtejshme të ZPS-së").

të bazuara tërësisht vetëm në të drejtën ndërkombëtare zakonore, si dhe shtrirja e krimeve të pretenduara në Aktakuzë, së bashku me rregullat e posaçme procedurale të zbatueshme para DHSK-së – tregojnë që tribunalët *ad hoc* ose GJPN-ja janë tregues më të mirë se kur do të fillojë kjo çështje. Në ato gjykata, asnjë çështje që përfshin katër ose më shumë të akuzuar para një tribunali ndërkombëtar nuk ka filluar më shpejt se një vit pas paraqitjes së parë të të akuzuarve, sikurse sugjeron ZPS-ja. Në të vërtetë, periudha prej tetëmbëdhjetë muajsh deri në dy vjet shpesh konsiderohet si kohëzgjatje e përshtatshme e procedurës paraprake.

13. Me gjithë përpjekjen e cekët të ZPS-së për të bërë dallimin midis procedurave aktuale dhe atyre para TPNJ-së, asnjë nga këto arsye nuk është bindëse dhe është e qartë që ato nuk i japin Mbrojtjes “mundësi të barabartë për t’u përgatitur për gjykim”³ dhe nuk zbatohen të drejtën e Mbrojtjes për të pasur “kohë të mjaftueshme për t’u përgatitur”⁴, sikurse pretendon ZPS-ja.
14. Prandaj, në vlerësimin e kësaj kërkesë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të jetë plotësisht i vetëdijshëm se kur do të fillojë gjykimi në të vërtetë dhe jo se kur dëshiron, shpreson, apo sugjeron ZPS-ja që mund të fillojë. Marrja e vendimit për lirim të përkohshëm me bindjen se gjykimi do të fillojë pas gjashtë muajsh do të ishte premisë thellësisht e gabuar dhe vetëm do të dëmtonte çdo vendim të marrë.

B. Vlerësimi individual i z. Selimi

15. Aktakuza në këtë çështje gjyqësore pretendon ekzistencën e një ndërmarrjeje të kriminale përbashkët me shtrirje të gjerë, ndërmjet katër të akuzuarve në këtë çështje dhe bashkëkryesve të tjerë të tyre për të cilët nuk është paraqitur aktakuzë,⁵ duke i ngarkuar z. Selimi veprimet dhe mosveprimet e anëtarëve dhe instrumenteve të tjerë të pretenduar të NKP-së. Po kështu, kërkesa e ZPS-së për fletarrestime përmban një varg akuzash kundër të katër të akuzuarve në këtë çështje, shpesh pa ndonjë përpjekje të mirëfilltë për të bërë dallimin midis rrethanave ose sjelljeve të tyre individuale.

³ Po aty, para. 14.

⁴ Njëjtë, para. 13.

⁵ Aktakuza, para. 32-52.

16. Ndonëse në kohën e duhur Mbrojtja do të kundërshtojë fuqishëm ekzistencën dhe kriminalitetin e çfarëdo ndërmarrjeje të përbashkët të pretenduar, është edhe më jetike që z. Selimi të vlerësohet individualisht për sjelljen e tij sipas kritereve të nenit 41(6) në kuadrin e kësaj kërkesë për lirim. Veprimet e pretenduara të bashkëkryesve, konspiratorëve për të cilët nuk është paraqitur aktakuzë, ose edhe të individëve që nuk kanë asnjë lidhje me z. Selimi nuk duhet të shërbejnë si bazë për të përligjur vazhdimin e paraburgimit të tij.

C. Dyshimi i bazuar

17. Mbrojtja vë në dukje se kur lëshoi fletarrestimin për z. Selimi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake iu referua vendimit të tij të mëparshëm që konfirmonte aktakuzën ku ai “konstatoi se ekziston dyshimi i bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer krime brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara” dhe rrjedhimisht “është përmbushur kushti i parë i nenit 41(6)(a) të Ligjit.”⁶ Ndonëse Mbrojtja nuk pajtohet se ky standard është përmbushur për sa i përket z. Selimi, në mungesë të nxjerrjes së materialit mbështetës të aktakuzës në kohën kur po bëhet kjo kërkesë, në këtë fazë ende nuk mund të bëhen parashtrime të dobishme. Sidoqoftë, Mbrojtja rezervon të drejtën për ta ngritur këtë çështje pas marrjes të materialit në përputhje me rregullën 102(1)(a).

D. Rreziku i arratisjes

18. Z. Selimi është figurë publike, i mirënjohur në mbarë Kosovën si politikan në partinë politike Vetëvendosje dhe aktualisht është deputet i kësaj partie në Kuvendin e Kosovës, ku është gjithashtu edhe kryetari i grupit parlamentar të Vetëvendosjes. Sikurse shpjegohet nga z. Albin Kurti,⁷ udhëheqësi i partisë më të madhe politike dhe ish-kryeministër i Kosovës, veprimtaria patriotike dhe politike e z. Selimi është karakterizuar gjithmonë nga përkushtimi i plotë, nderi dhe integriteti në ushtrimin e detyrave të tij. Këto detyra kanë qenë të konsiderueshme, duke filluar me postin e ministrit të punëve publike në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës (1999-2000), atë të

⁶ Vendimi për fletarrestime, para. 26, që i referohet: Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim për konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, KSC-BC-2020-06/F00026, 26 tetor 2020, para. 474, 478, 482, 491, 498, 505, 512 (“Vendimi i konfirmimit”).

⁷ Shtojca 1- Deklaratë e z. Albin Kurti.

komandantit të Akademisë së Mbrojtjes (2000-2003), dhe së fundi si deputet i Vetëvendosjes në Kuvendin e Kosovës.

19. Z. Selimi ka bashkëpunuar plotësisht me hetimet e ZPS-së. Kur u thirr për intervistë nga ZPS-ja, ai u paraqit vullnetarisht dhe u intervistua për tri ditë nga ZPS-ja, më 12, 13 dhe 14 nëntor 2019. Organizimin e udhëtimit për në Hagë dhe kthim ai e bëri vetë dhe udhëtoi nga Prishtina për të marrë pjesë në intervistën me ZPS-në. Me kërkesë të ZPS-së, ai u kthye në Hagë nga Prishtina për t'u intervistuar edhe dy ditë të tjera, më 18 dhe 19 shkurt 2020. Z. Selimi iu përgjigj pyetjeve të ZPS-së dhe nuk shfrytëzoi të drejtën për përfaqësim juridik gjatë intervistave. [REDAKTUAR].
20. Gjithashtu, z. Selimi bashkëpunoi plotësisht kur u informua se aktakuza kundër tij ishte konfirmuar. Pasi u informua një ditë para arrestimit se aktakuza kundër tij ishte konfirmuar, atij iu dha mundësia të paraqitej vetë të nesërmen në mëngjes. Z. Selimi u paraqit vullnetarisht dhe në kohë në vendin e zgjedhur.⁸
21. [REDAKTUAR].
22. [REDAKTUAR]. Kjo është tërësisht në përputhje me dëshmitë e shkëlqyera për karakterin⁹, që i janë bashkëngjitur kësaj kërkesë, në të cilat jepen vlerësimet më të larta për karakterin e mirë të z. Selimi. Këto dëshmi për qëndrimin e tij të përgjegjshëm dhe të përkushtuar ndaj jetës qytetare, profesionale dhe familjare, të shkruara nga tre individë që e kanë njohur shumë mirë z. Selimi për një periudhë prej rreth njëzet vitesh, përmbajnë të gjitha elementët karakteristikë të së vërtetës. Pretendimet e prokurorisë se tani z. Selimi përbën rrezik real për pengimin e zhvillimit të procesit të drejtësisë ose kryerjen e veprave penale, të cilat nuk mbështeten në asnjë provë bindëse, bien krejtësisht ndesh me historinë faktike personale të tij gjatë 20 viteve të fundit. Argumentet e prokurorisë nuk i qëndrojnë as shqyrtimit më sipërfaqësor.
23. Duke pasur parasysh këtë shkallë bashkëpunimi me hetimet e ZPS-së (që duket se nuk i është bërë e njohur Gjykatësit të Procedurës Paraprake kur ZPS-ja kërkoi fletarrestim

⁸ Prokurori k. Thaçit dhe të tjerëve, Versioni publik i redaktuar i 'Raportit mbi arrestimin dhe transferimin e Rexhep Selimit në objektin e paraburgimit', KSC-BC-2020-06/F00071, 10 nëntor 2020, para. 4-5.

⁹ Shtojca 1 – Deklarata e Albin Kurtit; Shtojca 2 – Deklarata e [REDAKTUAR], Shtojca 3 – Deklarata e Shyqri Nimanit

për z. Selimi), si dhe bashkëpunimin e tij me punonjësit e policisë gjatë arrestimit dhe transferimit në Hagë, konstatimi i mëparshëm i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se katër faktorë “demonstrojnë se [z. Selimi] ka motivin dhe mjetet për t’u arratisur”¹⁰ është i pabazuar.

24. Së pari, fakti që z. Selimi u vu zyrtarisht “në dijeni për akuzat e paraqitura në aktakuzën që do t’i dorëzohet, si dhe për dënimet e mundshme, që mund të përfshijnë dënim deri në burgim të përjetshëm,”¹¹ nuk e ndryshon situatën thelbësisht nga ajo që ishte gjatë intervistimit të tij. Duke pasur parasysh tematikat e trajtuara në intervistë dhe pyetjet që iu bënë atij si i dyshuar, z. Selimi ishte plotësisht në dijeni për fushat e interesit të ZPS-së, pretendimet lidhur me të cilat mund të bëhej objekt i ndjekjes penale dhe dënimet përkatëse. Megjithëse i dinte këto, nuk ka asnjë tregues se z. Selimi bëri ndonjë përpjekje të arratiset nga juridiksioni i Kosovës dhe ai u dorëzua vullnetarisht në policinë e Kosovës.

25. [REDAKTUAR],¹² [REDAKTUAR].

26. Së treti, funksioni i z. Selimi si anëtar aktual i Kuvendit të Kosovës, jo vetëm që nuk përbën provë për motivin dhe mjetet për t’u arratisur, por në fakt demonstroi detyrimin e tij për të qëndruar në Prishtinë dhe për të përmbushur detyrat e tij si përfaqësues i zgjedhur. Gjithashtu, pretendimi se pozita e tij aktuale dhe pozitat e tij të mëparshme “i mundësojnë atij të mobilizojë një rrjet të gjerë përkrahësish dhe zyrtarësh qeveritarë” nuk mbështetet në asgjë tjetër përveçse në pretendimin e vetë ZPS-së lidhur me këtë.¹³ ZPS-ja nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të pretendimeve të tilla dhe duket se mbështetet në rrjetet e pretenduara të të tjerëve, çka vetëm i mohon z. Selimi të drejtën që të trajtohet si individ.

27. Së katërti, dhe për të njëjtat arsye si më lart, nuk ka asnjë provë të paraqitur nga ZPS-ja apo të identifikuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake se z. Selimi ka qasje në fonde të konsiderueshme.¹⁴ Përsëri, ky konstatim i Gjykatësit të Procedurës Paraprake

¹⁰ Vendimi për fletarrestime, para. 36.

¹¹ Po aty.

¹² Kërkesa e ZPS-së, para. 31.

¹³ Po aty.

¹⁴ *Prokurori kundër Thaçit dhe të tjerëve*, Kërkesë e Mbrojtjes në pajtim me rregullën 71(3), KSC-BC 202006/F101, 25 nëntor 2020.

nuk bazohet në asgjë tjetër përveçse në pretendimin e vetë ZPS-së. Në fakt, siç është tashmë në dijëni Gjykatësi i Procedurës Paraprake, familja e z. Selimi varet plotësisht nga paga e tij si deputet për shpenzimet e jetesës,¹⁵ [REDAKTUAR]. Pretendimet e mjegullta dhe të pabaza për korrupsion, që kanë lidhje me individë të tjerë dhe jo me z. Selimi, nuk mund të shërbejnë si bazë për të pretenduar se ai ka qasje në fonde.

28. Së pesti, thjesht fakti se z. Selimi posedon pasaportë, nuk do të thotë se ai ka motivin të arratiset. Z. Selimi nuk ka asnjë lidhje të rëndësishme me shtete të tjera, qoftë nëse janë shtete që e njohin Kosovën ose jo, përveç se me Kosovën dhe Shqipërinë. Gjithsesi, si kusht elementar për lirim të përkohshëm, z. Selimi do të duhet t'ia dorëzojë pasaportën autoriteteve të Kosovës, kusht që ai është më se i gatshëm ta përmbushë.

E. Pengimi i procedimit

29. Parashtrijmë me respekt se konstatimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se z. Selimi “ka motivin, mjetet dhe mundësinë për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve, viktimave dhe bashkëkryesve dhe, rrjedhimisht, për të penguar ecurinë e procedimit penal” bazohet në informacion të paplotë, të pasaktë, ose jorelevant të paraqitur nga ZPS-ja. Pretendimet e mjegullta dhe të pabaza për ndërhyrje ndaj dëshmitarëve të paraqitura kundër të akuzuarve të tjerë ose kundër individëve që nuk kanë lidhje me të, nuk përbën arsye për refuzimin e lirit të përkohshëm të tij mbi këtë bazë.

30. Së pari, Mbrojtja tashmë i është përgjigjur pretendimit më lart se pozita aktuale e z. Selimi në Kuvendin e Kosovës shton rrezikun e arratisjes dhe kjo përgjigje vlen edhe për pyetjen nëse kjo shton mundësinë ose motivin e tij për të penguar hetimet. Të dy pozitat e tij e mëparshme në pushtet, si shef i Drejtorisë Operative të UÇK-së dhe ministër i rendit publik, z. Selimi i ka mbajtur më shumë se njëzet vjet më parë dhe në kohën e Qeverisë së Përkohshme. ZPS-ja nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete për ekzistencën e një rrjeti të gjerë përkrahësish dhe/ose për mundësinë konkrete të z. Selimi për të ndikuar tek ta sot. Z. Selimi është një nga 120 anëtarët e Kuvendit të Kosovës dhe nuk ka as më shumë e as më pak pushtet se cilido deputet tjetër. Sidoqoftë,

¹⁵ [REDAKTUAR].

pozita e tij si anëtar i Kuvendit dhe obligimet që ka ndaj zgjedhësve për shkak të kësaj pozite, janë argument i fuqishëm kundër motivimit për të penguar procedimin.

31. Si politikan dhe burrë shteti, z. Selimi ka treguar gjithmonë respektin më të madh për shtetin ligjor dhe parimet demokratike. Ndonëse është e saktë se z. Selimi dhe kolegët e tij janë shprehur hapur dhe publikisht në Kuvendin e Kosovës kundër themelimit të DHSK-së, argumentet e tyre transparente ishin të natyrës ligjore dhe politike. Në vend të DHSK-së, ata propozuan modelin e një gjykate vendore në Kosovë, e cila do të gjykonte dhe hetonte në mënyrë të plotë veprat penale që pretendohet të jenë kryer gjatë luftës. Në përputhje me këtë, z. Selimi nuk votoi në favor të ligjit që çoi në ndryshimet e kushtetutës dhe krijimin e DHSK-së. Megjithatë, ai nuk ka qenë në asnjë fazë pjesë a përpjekjeve jodemokratike për të penguar përparimin e DHSK-së.
32. Së dyti, mbështetja e ZPS-së në pretendime jorelevante për pengim të veprimtarisë së UNMIK-ut dhe përfshirjen si pasojë të z. Selimi në një listë të zezë të qeverisë së SHBA-së, nxjerr në pah natyrën hamendësuese të pretendimeve të ZPS-së sipas kësaj dispozite dhe zbatimin e gabuar jashtëterritorial të pushtetit të ShBA-së. Përfshirja në këtë listë duket se nuk kërkon asgjë më shumë se autorizimin e Presidentit, pa ndonjë mbikëqyrje të qartë dhe transparente gjyqësore. ZPS-ja e di fort mirë se, rrjedhimisht, në këto lista personash mund të përfshihet kushdo, ndër të cilët, kohët e fundit, edhe Prokurori i Gjykatës Penale Ndërkombëtare. Kjo flet qartë për natyrën politike dhe arbitrare të përcaktimeve të tilla dhe e dobëson së tepërmi mbështetjen e Prokurorisë tek përfshirja e z. Selimi në këtë listë si argument lidhur me vendimin për lirim të përkohshëm.
33. Gjithashtu, me gjithë përpjekjet e z. Selimi për të kuptuar arsyet e këtij urdhri dhe për ta kundërshtuar atë, duke kërkuar i vazhdimisht informacion Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë në periudhën midis viteve 2001 dhe 2003, atij nuk i është dhënë informacioni i nevojshëm apo mjetet për ta kundërshtuar atë. Nëse emri i z. Selimi është ende në regjistrin e SHBA-së edhe sot, kjo nuk tregon asgjë tjetër përveç ngathtësinë e burokracisë qeveritare dhe nuk është provë e besueshme për t'u përdorur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

34. [REDAKTUAR]¹⁶ [REDAKTUAR].
35. [REDAKTUAR].
36. [REDAKTUAR].
37. [REDAKTUAR].
38. [REDAKTUAR].
39. [REDAKTUAR]¹⁷ [REDAKTUAR]¹⁸ [REDAKTUAR].
40. [REDAKTUAR].¹⁹
41. [REDAKTUAR].

F. Kryerja e krimeve të tjera

42. Mbështetja e Gjykatësit të Procedurës Paraprake thjesht mbi ekzistencën e pretendimeve për pjesëmarrje në një NKP kundër kundërshtarëve realë ose të perceptuar të UÇK-së, duket se përbën një hap prapa në kërkesën për lirim të përkohshëm. Për shkak të vetë natyrës së DHSK-së dhe juridiksionit të saj mbi krime të rënda, të gjitha aktakuzat e konfirmuara do të përmbajnë akuza të rënda. Kjo nuk do të thotë se për krime të tilla nuk mund dhe nuk duhet të miratohet lirimi i përkohshëm, sepse përndryshe, vetë akti i konfirmimit të aktakuzës do ta bënte të pamundshëm lirimin e përkohshëm.
43. Parashtrojmë me respekt se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të bëjë vlerësim të plotë se çfarë rreziku faktik ka që vetë z. Selimi, në qoftë se lirohet tani, do të përdorë dhunën fizike ose kërcënimin me dhunë fizike kundër atyre që perceptohen si kundërshtarë të UÇK-së. Ndonëse Mbrojtja nuk e mohon se pretendimet e paraqitura në aktakuzë kanë rëndësi në kryerjen e këtij vlerësimi, sikurse kanë edhe data data dhe

¹⁶ Vendimi për fletarrestime, para. 37.

¹⁷ Vendimi për fletarrestime, para. 37.

¹⁸ [REDAKTUAR].

¹⁹ [REDAKTUAR].

konteksti në të cilin kanë ndodhur ato, gjatë vlerësimit të rrezikut Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të shqyrtojë gjithashtu edhe pasojat për z. Selimi si edhe rrethanat e tij profesionale dhe familjare.

44. [REDAKTUAR].

G. Garancitë shtetërore

45. Mbrojtja vë në dukje se nuk është detyrim i të akuzuarit të kërkojë garanci shtetërore si parakusht për lirim të përkohshëm, por se kjo konsiderohet e “këshillueshme” për të bindur Dhomën se i akuzuari do të paraqitet për gjykim.²⁰ Megjithëse garanci të tilla “mund të kenë peshë të konsiderueshme në mbështetjen e kërkesës për lirim të përkohshëm”, Dhoma përsëri duhet të marrë në shqyrtim nëse “është e mundur që rrethanat personale të të akuzuarit ta bindin trupin gjykues se ai do të paraqitet për gjykim”²¹ edhe në mungesë të garancive shtetërore. Për më tepër, lirimi i përkohshëm është miratuar edhe në raste kur shteti përkatës është shprehur qartë se nuk mund të garantonte paraqitjen e të akuzuarit në gjykim dhe se i akuzuari nuk do të përbënte rrezik për viktimat, dëshmitarët ose persona të tjerë.”²²

46. Mbrojtja gjithashtu vë në dukje se në bazë të nenit 1(2) të Ligjit, Dhomat e Specializuara janë pjesë e sistemit të drejtësisë të Kosovës. Ndryshe nga TPNJ-ja dhe GJPN-ja, të cilat janë gjykata ndërkombëtare që janë të varura nga bashkëpunimi i autoriteteve kombëtare, DHSK-ja mund të ketë besim tek zbatimi i drejtpërdrejtë i vendimeve të saj. Rrjedhimisht, është e qartë se në DHSK nuk kërkohet e as nuk parashikohet garancia shtetërore për miratimin e lirimimit të përkohshëm.

²⁰ *Prosecutor v. Blagojevic et al.*, IT-02-53-AR65, Decision on Application by Dragan Jokic for Leave to Appeal, 18 prill 2002, para. 7-8; *Prosecutor v. Cermak and Markac*, IT-03-73-AR65.1, 2 dhjetor 2004, Decision on Interlocutory Appeal Against Trial Chamber's Decision Denying Provisional Release, para. 30; *Prokurori kundër Beqajt*, Urdhër për lirim të përkohshëm, 4 mars 2005, p. 4; *Prosecutor v. Karemera et al.*, ICTR-98-44-AR-65, Decision on Matthieu Ndirumpatse's Appeal Against Trial Chamber's Decision Denying Provisional Release, 7 prill 2009 ("Vendimi Ndirumpatse"), para. 13; *Prokurori kundër Haraqijës dhe Morinës*, IT-04-84-R77.4-A, Vendim mbi mocionin e Astrit Haraqijës për lirim të përkohshëm, 8 prill 2009, para. 8.

²¹ Vendimi Ndirumpatse, para. 13.

²² *Prosecutor v. Turinabo et al.*, Decision on Marie Rose Fatuma's Second Motion for Provisional Release to Rwanda, 29 korrik 2019, f. 2.

H. Kushtet për lirim të përkohshëm

47. Edhe pse Mbrojtja parashton se nuk është përmbushur asnjë kriter i nenit 46(1)(b), ajo propozon si alternativë disa kushte të ndryshme të cilat do të minimizojnë çdo rrezik të mundshëm që z. Selimi të arratiset, të pengojë procedurat ose të kryejë krime të tjera sipas nenit 41(12).
48. Këto kushte janë përdorur shpesh nga gjykata të ndryshme ndërkombëtare për të siguruar paraqitjen e të akuzuarve ose për të mbrojtur integritetin e procedurave. Ndër to mund të përfshihen kushtet që ai:
- a. të banojë dhe të qëndrojë tërë kohën në shtëpinë e tij të banimit në Prishtinë, Kosovë;
 - b. t'i dorëzojë zyrtarëve të autorizuar të DHSK-së pasaportën dhe çdo dokument të vlefshëm udhëtimi, përfshirë edhe letërnjoftimin e Kosovës me të cilin mund të udhëtojë në Shqipëri;
 - c. të paraqitet rregullisht ose në një stacion policie në Prishtinë ose në zyrat e policisë të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë ("EULEX"), sipas kërkesës;
 - d. të respektojë masat mbrojtëse që vazhdojnë të jenë në fuqi para DHSK-së ose që mund të urdhërohen nga DHSK-ja;
 - e. të mos e diskutojë çështjen e tij me askënd, përfshirë edhe mediat, përveçse me mbrojtësin ose anëtarët e ekipit të mbrojtësit që janë miratuar si të tillë nga Zyra Administrative e DHSK-së;
 - f. të kthehet në DHSK në datën që do të caktohet nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose paneli;
 - g. të respektojë rreptësisht çdo urdhër të ardhshëm të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për ndryshimin e kushteve ose përfundimin e lirim të përkohshëm; dhe, çfarëdo kushti tjetër që mund të vendosë Gjykatësi i Procedurës Paraprake lidhur me lirim të tij.

I. Seanca gojore dhe kërkesa për përgjigje të shpejtë nga ZPS-ja

49. Mbrojtja kërkon që, krahas marrjes së parashtrimeve me shkrim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake të mbajë edhe një seancë gojore në lidhje me këtë kërkesë për lirim të përkohshëm. Seanca gojore do t'u mundësonte palëve të diskutojnë çfarëdo aspektesh ende të patrajtuara dhe t'u përgjigjen pyetjeve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, nëse është e nevojshme.
50. Gjithashtu, Mbrojtja kërkon me respekt nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që të shkurtojë afatin e përgjigjes së ZPS-së ndaj këtij mocioni nga dhjetë, në katër ditë. Kjo do të mundësonte diskutimin dhe përgatitjen për këtë çështje para seancës gojore të kërkuar më lart dhe do të mundësonte lëshimin e vendimit lidhur me kërkesën para fillimit të pushimit dimëror.

IV. PËRFUNDIM DHE MASA NDREQËSE E KËRKUAR

51. Në lidhje me sa më sipër, Mbrojtja kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që:
- të urdhërojë lirim të përkohshëm të z. Selimi, me ose pa kushte;
 - të shkurtojë afatin e përgjigjes së ZPS-së ndaj kësaj kërkesë, duke e caktuar atë për ditën e premte, 11 dhjetor 2020; dhe,
 - të caktojë një seancë gojore për këtë kërkesë më 16 dhjetor 2020 ose rreth kësaj date.

Paraqitur me respekt më 12 dhjetor 2020,

/nënshkrim/

DEJVID JANG
Mbrojtësi kryesor i Rexhep Selimit

/nënshkrim/

XHEFRI ROBERTS
Bashkëmbrojtësi i Rexhep Selimit